

Raport për rezultatet e konsultimeve publike për projektligjin:

“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, i ndryshuar”

1. Titulli i draft aktit

“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, i ndryshuar”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Gjatë vitit 2024, IdentiTek sh.a në cilësinë e Shoqërisë e cila prodhon dhe shpërndan dokumentin biometrik për shtetasit shqiptar, ka paraqitur pranë Këshillit Mbikëqyrës, projekt-idenë për identitetin digjital, si një nga objektivat e Bashkimit Evropian, në përputhje me programin politik të Qeverisë Shqiptare. Në vijim, IdentiTek dhe Ministria e Brendshme hartuan projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, i ndryshuar”, projekt i cili u finalizua gjatë takimeve të përbashkëta të palëve.

Gjithashtu, projektvendimi u publikua në RENJKP përgjatë periudhës 30 prill 2024 deri në 29 maj 2024, në respektim të afateve ligjore. Projektakti ka pasur 384 lexime në Regjistrin Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik dhe një koment nga një qytetar në postën elektronike të koordinatorit të sistemit.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, i ndryshuar” janë tre:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet, RENJK.
2. Komunikime elektronike (nëpërmjet postës zyrtare elektronike).

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit. Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese. Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

- Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator
- IdentiTek
- Msc. Adem Qoraj, Senior Electrical Engineer

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/refuzuara

Gruponi komentet/propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Konceptet si e-ëallet, duke pasur parasysh parasysh direktivat e EU për EU Digital Identity Ëallet	Do të merren parasysh direktivat e BE-së për EU Digital Identity Ëallet, dhe nëse është	Msc. Adem Qoraj Senior Electrical Engineer	Refuzuar	Në parim çdo miratim ligji ose akti nënligjor kryhet në përputhje me

	<p>konsultuar me ofruesit më të mëdhenj të teknologjisë Wallet si Google dhe Apple. Për më tepër, mundësimi i shërbimeve në Google Wallet apo Apple Wallet ofron mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve, shembull; për të verifikuar moshën për shërbime të caktuara nuk është e nevojshme të japësh datëlindjen e plotë.</p> <p>Duke qenë se tashmë ekziston një aplikacion si e-Albania që ofron pjesën më të madhe të shërbimeve shtetërore, nëse shërbimet ekstra të ID do të ofroheshin në Google apo Apple Wallet, atëherë do të eliminohej nevoja për krijimin dhe mirëmbajtjen e një aplikacioni shtesë. Në këtë formë, e-Albania mund të plotësojë të gjitha</p>			<p>direktivat e Bashkimit Evropian. Edhe ndryshimi i propozuar nga Ministria e Brendshme, si organ politikëbërës, merr shkas nga risitë e fundit në nivel ndërkombëtar në këtë fushë. Fokusi është digjitalizimi i mëtejshëm i vendit edhe në fushën e identitetit.</p>
--	---	--	--	---

	<p>kushtet e direktivave europiane, ndërsa Google Ëallet thjeshton ndërveprimin me telefonat mobilë. Google mbështet një integrim që nga identiteti, tek karta e shëndetit, studentit, lejet e drejtimit, etj., pa pasur nevojë të krijohet një strukturë e re.</p>			
--	---	--	--	--